



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/1038**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Ejona ” Sh.P.K.”, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve te Komunës” me nr. të prokurimit: "616-23-3831-5-2-1",, me 20/02/2024, mori:

### Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “Ejona ” Sh.P.K.” me nr. 2023/1038 , e datës 21/12/2023, kurse vendimi i AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve te Komunës” me nr. të prokurimit: "616-23-3831-5-2-1", anulohet dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

*- Faktet dhe rrethanat procedurale --*

Me 28.04.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Instalimi dhe

rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "616-23-3831-5-2-1". Ndërsa me datën 14.06.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Uplift L.L.C”,

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **180,000.00 €**.

Me 05.12.2023, OE “Ejona " Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 11.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Ejona " Sh.P.K.” me nr. 1038/23 për lidhur me aktivitetin “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "616-23-3831-5-2-1".

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona " Sh.P.K.”, janë parashtruar si në vijim:*

*Pretendimi i parë (I): Ankuesi pretendon: “AK edhe njëherë shpalle fitues OE "UP LIFT" i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DT, duke shkelur Nenin 69 përkatësisht paragrafin 6.1. Edhe pse vendimi i OSHP-se për këtë aktivitet citon: "është evidente se janë paraqitur 3 teknike ndërsa dëshmitë lidhur me 2 prej tyre mungojnë, kështu që ky pretendim konform raportit të ekspertizës klasifikohet i bazuar," Pra, OE i shpallur fitues ka prezantuar diplomën si Teknik i ndërtimitarisë vetëm për 1 teknik, ndërsa për 2 të tjerë ka dërguar diploma të degëve të tjera që nuk kanë të bëjnë me degën e ndërtimitarisë (Matematike, Shkenca natyrore, Makineri). Ia rikujtojmë AK se në DT ka qenë kërkesë që në këtë projekt të angazhohet stafi profesional, pasi që natyra e këtij projekti është Ekzekutim i punëve dhe në staf profesional të paraqiten 3 teknike të ndërtimitarisë ku si dëshmi për aftësinë e tyre profesionale të prezantohet Diploma. OE i shpallur fitues ka dështuar ta dëshmojë se Stafi i paraqitur nga ta ka kualifikimet e kërkuara në DT dhe në Njoftimin për Kontratë. Pra, AK ka vepruar në kundërshtim me LPP, përkatësisht Nenin 69, duke shpallur 4/3. Sipas pretendimit të AK-se për të dëshmuar aftësinë profesionale si Teknik i ndërtimitarisë mund të vlejë secila diplome, atëherë sipas AK i bie se edhe për inxhinierin e kërkuar, paskemi mundur të prezantojmë një diplome të degës së Historisë për të plotësuar kriteret e vena në DT?! Andaj, ky pretendim i AK është i pabazuar por edhe shumë qesharak, sipas mendimit të tone. Në kërkojmë nga OSHP që të obligojë AK të respektojë LPP*

përkatësisht Nenin 69 , paragrafi 6.1 , ku OE duhet te prezantoje diploma qe dëshmojnë aftësinë profesionale ne këtë rast (Teknik i Ndërtimtarisë- dëshmia: Diploma e shkollës se mesme teknike Dega Ndërtimtari).. ”

*Pretendimi i dytë (II):* “AK nuk ka vlerësuar dhe ekzaminuar dosjet e tenderuesve sipas LPP-së përkatësisht Neni 59 paragrafi 4. Duke shpallur fitues një OE i cili nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në DT.”

*Pretendimi i tretë (III) :* “Neni 97 Shkeljet e rënda h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik, përkatësisht piken h. duke mos respektuar vendimin e OSHP. Ani pse, OSHP konstaton në vendimin e tij se Diplomat për Tekniket e Ndërtimtarisë janë të domosdoshme për të dëshmuar aftësinë e tyre profesionale, AK përsëri shpall fitues OE i cili nuk arrin të dëshmojë aftësinë profesionale të teknikeve. Kjo pasi që në stafin e prezantuar nga OE vetëm 1 prej tyre është teknik i ndërtimtarisë, nga 3 sa janë kërkuar dhe 2 te tjerë nuk kanë fare lidhje me fushën e ndërtimtarisë. Në ankesë gjeni të bashkangjitur diplomat që ka prezantuar OE i shpallur fitues për tekniket e ndërtimtarisë, diploma të cilat janë të degëve: Shkenca natyrore, Matematike, dhe Makineri. Pra asnjëra diplome nuk është e degës së ndërtimtarisë.”

***Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Ejona ” Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 69, 59, 97 të LPP-së. Ne kërkojmë nga OSHP që të detyroje AK ta respektojë vendimin e pare të OSHP-se, të anulojë vendimin dhe të kthejë lenden në rivlerësim. Duke shpallur OE "UPLIFT" si të eliminuar nga gara pasi ka dështuar të dëshmojë arritjen profesionale të teknikeve.***

***Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim:*** “Operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 05.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe rregullimi i liftave të objekteve të komunës" me nr. të prokurimit 616-23-3831-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in meritum) të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim: "Edhe pse vendimi i OSHP-se për këtë aktivitet citon: është evidente se janë paraqitur 3 teknike ndërsa dëshmitë lidhur me 2 prej tyre mungojnë, kështu që ky pretendim konform raportit të ekspertizës klasifikohet i bazuar, " Pra, OE i shpallur fitues ka prezantuar diplomën si Teknik i ndërtimtarisë vetëm për 1 teknik, ndërsa për 2 te tjerë ka dërguar diploma të degëve të tjera që nuk kanë të bëjnë me degën e ndërtimtarisë". Fillimisht duhet sqaruar se pretendimi ankimor i referohet kërkesës në dosjen e tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim gjeni të bashkangjitur një tabelë ku bëhet edhe sqarimi.Me datë 06.072023 parashtruesi ka dorëzuar në OSHP një ankesë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht me datë 08.11.2023 OSHP ka nxjerrë vendimin me nr. 2023/0471 në të cilin ndër të tjera në faqen me nr. 6 ka konstatuar si vijon: "Lidhur me kërkesën si në vijim, për 3 teknike të ndërtimtarisë mund të nënkuptohet se si dëshmi janë kërkuar CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt ndërsa referencat i referohen inxhinierëve, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga palët si

dhe nga shkresat e evidentuara të lëndës në e-prokurimi është evidente se janë paraqitur 3 teknikë ndërsa dëshmitë lidhur me 2 prej tyre mungojnë, kështu që ky pretendim konform raportit të ekspertizës klasifikohet i bazuar, megjithatë paneli konsideron se lidhur me këto dokumente me qenë se emrat e personave të angazhuar figurojnë në Ofertën e OE të rekomanduar, në këtë rast konsiderohet se mund të aplikohen dispozitat e neneve 59 si dhe 72 të LPP-së, që në rastin konkret duke zërthyer paragraf 1 dhe 3 të LPP-së të cilët lejojnë sqarimet dhe plotësimin e dokumentacionit". Duke u bazuar në këtë konstatim të Panelit Shqyrtues në OSH ku autoriteti kontraktues udhëzohet që të kërkoj sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar, me datë 27.11.2023 autoriteti kontraktues ka pranuar nga tenderuesi i rekomanduar sqarimet shtesë ku janë bashkangjitur CV, Kontratat e punës si "teknikë të ndërtimtarisë" dhe diplomat e kërkuara për katër (4) teknikët e ndërtimtarisë të përcaktuar me listën e stafit profesional me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Pra jo vetëm që janë dorëzuar dëshmitë e kërkuara sipas vendimit të OSHP por janë dërguar dëshmitë edhe për një (1) teknikë më shumë sesa që janë kërkuar me dosje të tenderit. Duhet sqaruar se në dosjen e tenderit lidhur me kërkesën për tre (3) teknikët e ndërtimtarisë janë kërkuar këto dëshmi dokumentare: 1. Kontrata e punës; 2. Diploma si dhe 3. CV. Kuptohet se kontrata e punës në këtë rast duhet të jetë e lidhur për pozitën "teknik të ndërtimtarisë" si staf profesional. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Ndërsa sipas dosjes së tenderit nuk janë kërkuar diplomat e fushës profesionale dhe as nuk është përcaktuar se për cilin nivel të shkollimit po kërkohet diploma. Përderisa në dosjen e tenderit nuk specifikohet diplomat e fushës profesionale por vetëm thuhet "diploma" atëherë aludimi i parashtruesit është i pabazuar në tërësi. Ngjashëm thuhet edhe sa i përket "CV" pra nuk përcaktohet lloji ose forma e CV. Përndryshe parashtruesi ka pasur mundësinë në faza të mëhershme të aktivitetit të prokurimit që të kontestoj edhe mënyrën se si është formuluar kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet mirëpo nuk ka bërë një veprim të tillë. Rrjedhimisht kërkesa ku kërkohet "diploma" pa specifikuar më tutje asgjë tjetër është e pakontestueshme as nga parashtruesi por as nga Paneli Shqyrtues në vendimin e cituar më sipër. Prandaj Paneli Shqyrtues në vendimin e cituar më sipër udhëzon AK vetëm që të kërkoj sqarime shtesë. Pikërisht në këtë mënyrë komisioni vlerësues ka vepruar me rastin e rivlerësimit. Rrjedhimisht me datës 27.11.2023 tenderuesi i rekomanduar i ka dërguar dëshmitë e kërkuara dokumentare për teknikët e ndërtimtarisë saktësisht sikurse janë kërkuar me dosjen e tenderit. Për këto arsye, pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara në tërësi. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1038/23, ndërsa me datë 03.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1038 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar Pajtohet me mendimin e ekspertit .

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

*Lidhur me pretendimet e OE “Ejona” Sh.P.K.”, - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1038 ka vlerësuar si në vijim:*

*Sqarim hyrës :* “Sqarim: Eksperti shqyrtues sqaron se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit ka qenë edhe një ankesë pikërisht për të njëjtin pretendim sikurse pretendimi i 1 i OE ankues e për të cilin është nxjerr vendimi i OSHP-se me nr. 471/23 ku rekomandohet “në këtë rast konsiderohet se mund të aplikohen dispozitat e neneve 59 si dhe 72 të LPP-së, që në rastin konkret duke zbërthyer paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së të cilët lejojnë sqarimet dhe plotësimin e dokumentacionit, por me kusht që ai “...do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.” kjo ndërlidhet me aplikimin e paragrafit 2 të nenit 59 të LPP i cili saktëson se lidhur me sqarimet e ofruara “...Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.”

*Konstatimi i parë (I):* “Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me kërkesat teknike dhe profesionale eksperti shqyrtues sqaron se sipas dosjes së tenderit është kërkuar: 2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme c. 3 teknike të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë. 2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë. Për të njëjtin pretendim në bazë të vendimit të OSHP me nr 472/23 është rekomanduar që të aplikohet neni 72 paragrafi 1 i LPP-se Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. AK-ja sipas vendimit të OSHP ka kërkuar sqarime përmes kërkesës për sqarim të datës 23.11.2023 të cilës i është përgjigjur OE i rekomanduar për kontratë me datën 27.11.2023. ME dokumente të njëjti ka bashkangjitur tri diploma: Diplomën me nr. 2330221/4 në emër të F.H me profilin – teknik i ndërtimtarisë, diplomën me nr. 1766 në emër të G.S.U me drejtimin – shkenca natyrore dhe diplomën me nr. 00210203 në emër të N.S me profilin Automekanik. AK-ja kërkesën për rishqyrtim të OE ankues e kishte hedh poshtë si të pabazuar me arsyetimin se : “Parashtruesi. Ndërsa sipas dosjes së tenderit nuk janë kërkuar diplomat e fushës profesionale dhe as nuk është përcaktuar se për cilin nivel të shkollimit po kërkohet diploma. Përderisa në dosjen e tenderit nuk specifikohet diploma e fushës profesionale por vetëm thuhet “diploma” atëherë

aludimi i parashtruesit është i pabazuar ne tersi. ”Eksperti shqyrtues sqaron se në bazë te UPP 001/2023 Neni 8.5 te Kriteret e Përzgjedhjes është e definuar qartë ndarja e kërkesës që duhet përmbushur dhe dëshmisë që duhet të dorëzohet për kërkesën.Përkundër faktit se nuk është kërkuar niveli i shkollimit te dorëzohet si dëshmi është e qartë se në bazë të kërkesës se dosjes se tenderit AK-ja ka kërkuar profilin “teknikë te ndërtimtarisë” derisa si dëshmi ndër të tjera është kërkuar edhe Diploma. OE i rekomanduar për kontratë ka dështuar ti dorëzojë dëshmitë sipas dosjes se tenderit kërkesa 9.1 & 9.2 2c) prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë rivlerësimit nuk e ka zbatuar nenin 40.6 b) lidhur me nenin 40.7 ii) te RRPP 001/2022 si dhe Neni59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve – Paragrafi 4 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderin fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin kontratës dhe në dosjen e tenderit Prandaj bazuar ne provat e administruara, dosjen e tenderit, kërkesën për rishqyrtim te OE ankues te datës 05.12.2023, Vendimin e AK-se ne kërkesë për rishqyrtim te datës 11.12.2023, sqarimet e OE te rekomanduar për kontratë te datës 27.11.2023, Vendimin e OSHP-se 471/23 si dhe vendimin qe i referohet OE i rekomanduar për kontratë me nr. 522/22 eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor ne këtë pikë është i bazuar.”

*Konstatimi i dytë (II) :* “Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues qe ka te beje me mosrespektimin e vendimit te OSHP-së me nr. 471/23 eksperti shqyrtues vlerëson se vendimi i OSHP vlerëson se: në këtë rast konsiderohet se mund të aplikohen dispozitat e neneve 59 si dhe 72 të LPP-së, që në rastin konkret duke zbërthyer paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së të cilët lejojnë sqarimet dhe plotësimin e dokumentacionit, por me kusht që ai “...do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.” kjo ndërlidhet me aplikimin e paragrafit 2 të nenit 59 të LPP i cili saktëson se lidhur me sqarimet e ofruara “...Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Ne këtë rast AK-ja ka vepruar në përputhje me vendimin e OSHP-se dhe ka kërkuar sqarime shtesë në përputhje me nenin 72 te LPP-se dhe si rrjedhoje eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues ne këtë pikë nuk është i bazuar.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona " Sh.P.K.”.,. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona " Sh.P.K.” janë të bazuara.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka

vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "616-23-3831-5-2-1" . Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona " Sh.P.K.” dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona " Sh.P.K.” janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik të aprovet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës” me nr. të prokurimit: "616-23-3831-5-2-1" , të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të veprojnë në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: